



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
PORTI DETAR SH.A SHËNGJIN

Nr. 3 Prot.

Shëngjin, më: 6 /10/ 2025

LËNDA: SHPALLJE PËR VEND TË LIRË PUNE

Mbështetur në Udhëzimin Nr.7 datë 11.06.2015 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së punonjësve të Forcës së Sigurisë në portet detare të Republikës së Shqipërisë”, Porti Detar Shëngjin Sh.A shpall konkursin për një vend të lirë pune në pozicionin Oficer Sigurie në Portin Detar Shëngjin. Dokumentat (kriteret) duhet të paraqiten pranë Sh.A Portit Detar Shëngjin në zarf të mbyllur. Njoftimi është shpallur në faqen web: [www//portidetarshengjin.al](http://www/portidetarshengjin.al)

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në Udhëzimin Nr.7 datë 11.06.2015 kreu IV të nenit 5 të këtij Udhëzimi theksohet kërkesa të vecanta për postin e drejtorit, oficerëve të Sigurisë së Porteve dhe Zonave të Sigurisë në Porti e Shëngjinit.

1. Kërkesat e vecanta për postin e Oficerit të Sigurisë së Portit Detar Shëngjin

a) Kandidatët që aplikojnë për postin e oficerit të sigurisë së Portit Detar Shëngjin, përvec dokumentacionit të paraqitur në aneksin 1 të këtij udhëzimi, duhet të dorëzojnë një CV të detajuar të shoqëruar me diplomat dhe certifikatat origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. CV- ja duhet të përmbajë arsimin, trajnimet, eksperiencën dhe aftësitë e kandidatit për të menaxhuar dhe për të drejtuar një forcë të sigurisë portuale dhe të përfshijë përvojën, njohuritë dhe dijet në fushat e mëposhtme:

- menaxhim,
- udhëheqje,
- detari,

- siguri,
- etike,
- legjislacionin për Forcat e Sigurisë,
- kodi ISPS i Organizatës Ndërkombëtare Detare.

b) Kriteria të veçanta, që duhen mbajtur parasysh gjatë intervistës dhe testimin me shkrim për përzgjedhjen e kandidatit për postin e Oficerit të Sigurisë së Portit Shëngjin janë:

- Të ketë përfunduar arsimin e lartë, preferohet Fakulteti i Navigacionit, Akademia e Marinës. Në rast se nuk ka konkurrent nga profili i marinës, kandidati mund të pranohet dhe me profil të Akademisë së Policisë ose të Akademisë Ushtarake;
- Të ketë eksperiencë pune 5 vjet ose më shumë, preferohet të ketë punuar si kapiten anije, oficer sigurie në Forcat e Sigurisë në Port ose të ketë eksperiencë pune të paktën 7 vjet si oficer në forcat e policisë ose të ushtrisë;
- Të ketë aftësi të mira komunikuese, drejtuese dhe negociuese;
- Të veprojë në mënyrë etike;
- Të ketë njohuri mbi ligjin për emergjencat civile, mbrojtjen kundër zjarrit dhe procedurat për parandalimin dhe reagimin ndaj tyre;
- Të njoh procedurat që kërkohen për zbatim me efektivitet të legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar lidhur me rregullat e sigurisë në porte dhe anije. Të njohë rregullat e bashkëveprimit të forcës së sigurisë me anijen. Të njohë kuadrin ligjor në fushën e detarise, si: Kodin Detar të Republikës së Shqipërisë, ligjin për sigurinë në anije dhe porte dhe kuadrin ligjor ndërkombëtar në fushën e sigurisë vecanërisht Kodin e Sigurisë në anije dhe porte, i IMO-së (ISPS).
- Të ketë njohuri të mira të gjuhës angleze në të folur dhe në të shkruar;

Dokumentat (kriteret) duhet të paraqiten pranë SH.A Portit Detar Shëngjin brenda datës 17/01/2025.

DREJTOR

SANDËR MARASHI

